



Datë: 09.07.2025
Numër Protokolli: 5137/2025

A.nr.876/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.876/2025, të datës 13.05.2025, të parashtruar nga ankuesja A.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.07.2025, mori këtë

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.876/2025, e datës 13.05.2025, e parashtruar nga ankuesja A.H.

II. Mbetët në fuqi Njoftimi i datës 08.05.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Obiliqit për rezultatet përfundimtare lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00017632, për pozitën *Zyrtar Administrativ*.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, A.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 13.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me reference RN00017632, për grupin administrimi i përgjithshëm “*Asistent Administrativ*” i shpallur nga Komuna e Obiliqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3146/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 13.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë të Komunës së Obiliqit, të datës 02.06.2025, Konkursi me numër reference RN00017632, për grupi i administrimit të përgjithshëm “*Asistent Administrativ*” i datës 15.04.2025 i shpallur nga Komuna e

Obiliqit; Konkursin me numër reference RN00016613 për grupi i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore “Asistent Administrativ” për realizimin e projektit me kohëzgjatje të emërimit për tri vite i datës 04.02.2025 i shpallur nga Komuna e Obiliqit; Vendimin me numër 02-020-01-3065-25 të datës 03.01.2025 për miratimin e projektit me numër 14-104-02-3034-35 nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për realizimin e objektivave sipas projektit; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe Listën e kandidatëve të refuzuar, Vendimin për themelimin e komisionit përzgjedhës për vlerësimin profesional të kandidatëve për pranim në shërbimin civil për pozitën Grupi i administrimit të përgjithshëm Asistent Administrativ- Projekt me nr. RN00017632; Akt emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Njoftimin për shpalljen e rezultateve përfundimtare; Aplikacionin e ankueses së bashku me dosjen; Aplikacionin e kandidatës fituese së bashku me dosjen; Formularët e vlerësimit individual të kandidatit në intervistë dhe vlerësimit të jetëshkrimit nga Komisioni i Pranimit; Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Obiliqit, më datë 15.04.2025, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00017632, Për realizimin e një projekti, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i Mesëm, gjegjësisht për pozitën “*Asistent Administrativ*”, me afat të aplikimit nga data 16.04.2025 deri më 23.04.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë gjashtë (6) kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë pesë (5) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila bazuar në Njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 08.05.2025, rezulton se nga kjo procedurë rekrutimi ka arritur gjithsejtë 62.33 pikë, të pajaftueshme për tu shpallur kandidatë fituese, rrjedhimisht e njëjta është renditur e dyta në këtë listë pas kandidatit fitues A.P, i cili me gjithsejtë 76.67 pikë të arritura, ishte shpallur kandidatë fituese për pozitën e punës *Asistent Administrativ*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për parregullsi në procedurën e shpalljes dhe përzgjedhjes, në kohëzgjatjen dhe barazinë e intervistimit dhe mos përfilljes së përgatitjes profesionale dhe përvojës përkatëse, andaj e njëjta thekson se nëse verifikohen këto shkelje të anulohet konkursi përkatës.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017632, për pozitën “*Asistent Administrativ*”, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të. b) Kërkesat specifike: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi; **Përvoja e punës e kërkuar:** Nuk kërkohet.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 37 paragrafit 3, 4, 5 dhe 6, ku përcaktohet se: 3. *Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 3.2. për plotësimin e një pozite në rast të*

mungesës së përkohshme. 4. Kontrata e punës për periudhë të caktuar sipas paragrafit 3. të këtij neni, lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.1. të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.2. të këtij neni. 5. E/i punësuar/i me kontratë sipas paragrafit 3. të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit civil, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit. 6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton procedurat për zbatimin e paragrafit 3. të këtij neni. Rrjedhimisht, Kolegji ju referuar dispozitave që përcaktojnë rregullat dhe procedurat për për realizimin e projektit të caktuar në shërbimin civil, sikurse është shpallur edhe Konkursi përkatës, gjegjësisht dispozitave ligjore të Rregullores (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, ku sipas:

-Nenit 7 paragrafit 7, 8 dhe 9 përcaktohet se : 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimin paraprak e bën NjMBNj e institucionit që zhvillon procedurën e përzgjedhjes ndërsa vlerësimin profesional e bën Komisioni i Përzgjedhje. 9. Në procedurën e verifikimit paraprak kandidatët nuk vlerësohen me pikë, ndërsa në vlerësimin profesional mund të vlerësohen deri në njëqind (100) pikë.

-Nenit 11, përcaktohet se: 1. Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga intervista dhe vlerësimi i jetëshkrimit dhe zhvillohet nga Komisioni i Përzgjedhjes me mbështetjen e NjMBNj. 2. NjMBNj njofton kandidatët që kanë kaluar verifikimin paraprak lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 3. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në shpalljen e konkursit. 4. Intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga Komisioni i Përzgjedhjes, i cili përgatit grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. 5. Intervista përmban dhjetë (10) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti shtatë (7) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 6. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti njëqind (100) pikë, prej të cilave tridhjetë (30) pikë për jetëshkrimin (CV). 7. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 7.1. deri në dhjetë (10) pikë për arsimimin; 7.2. deri në pesëmbëdhjetë (15) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 7.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet relevante. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe jetëshkrimin.;

Andaj, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses për parregullsi në procedurën e shpalljes dhe përzgjedhjes, në kohëzgjatjen dhe barazinë e intervistimit dhe mos përfilljes së përgatitjes profesionale dhe përvojës përkatëse, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses nuk mund vërtetohet si të bazuara përderisa nuk vërtetohen ndryshe me prova materiale, rrjedhimisht pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme, ngase ankuesja me asnjë dëshmi nuk e ka vërtetuar pretendimin lidhur me diferencën e kohëzgjatjes së saj me kundër kandidatin e përzgjedhur, ndërsa duke qenë se e njëjta ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference RN00017632, dhe ka marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve rrjedhë se edhe përgatitja profesionale dhe përvoja përkatëse është marrë për bazë nga Komisioni i Pranimit, përbërja e të cilit rezulton ka qenë në pajtim me nenin 13 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, dhe se Kolegji thekson se vlerësimi i përgjigjeve të ofruara nga kandidati sipas dispozitave ligjore të lartë theksuara është në diskrecion të Komisionit të Pranimit.

Theksuar si më sipër, dhe duke u bazuar në Nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i intervistës dhe jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve. 2. Pas përfundimit të intervistës dhe vlerësimit të jetëshkrimit, Komisioni i Përzgjedhjes përgatit listën përfundimtare të cilën e përcjellë tek NjMBNj në të cilën shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit si dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. 3. Lista publikohet në SIMBNj, në ueb faqen e institucionit dhe mjete të tjera të përshtatshme për informim. 4. Kandidati që merr më së shumti pikë por jo më pak se pragu prej shtatëdhjetë (70) pikëve, konsiderohet kandidat fitues;*, Kolegji Konstaton se Komisioni i Pranimit, me rastin e publikimit të Njoftimit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 08.05.2025, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat e sapo theksuara, ngase ankuesja nga vlerësimi i kësaj procedure rekrutimit ka arritur gjithsejtë 62.33 pikë, rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për kalimin pragut të kalueshmërisë prej 70 pikëve për tu shpallur kandidate fituese.

Ndërsa duke qenë se kandidati A.P, nga kjo procedurë rekrutimi ka arritur gjithsejtë 76.57 pikë të përgjithshme, si dhe duke marrë parasysh se me rastin e aplikimit të datës 16.04.2025, i njëjti ka bashkangjitur dokumentet të cilat dëshmojnë se plotëson kërkesat e përgjithshme formale të konkursit përkatës, gjegjësisht i njëjti ka bashkangjitur Diplomën me Numër protokolli 665, të datës 10.09.2015, për përfundimin e Shkollës së Mesme të Lartë-Gjimnazit “17 Shkurti” në Obiliq, si dhe po ashtu i njëjti rezulton se ka bashkangjitur edhe Diplomën me Nr.7101 të datës 13.10.2020, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti Filozofik, me të cilën dëshmohet se me datë 25.09.2020 ka fituar titullin Bachelor i Historisë si dhe Diplomën me Nr.2010 të datës 21.06.2024, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka fituar titullin Master i Historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Tutje nga aplikacioni i kandidatit A.P, rezulton se ka bashkangjitur Certifikatën mbi dënimet penale të lëshuar me datë 04.02.2025, nga Sistemi Qendrorë i Evidencës Penale, mbi të cilën dokument zyrtar dëshmohet se i njëjti nuk është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë, si dhe po ashtu ka bashkangjitur edhe kopjen e letërnjoftimit, i cili rezulton se ka afat dhe është valid deri më datë 29.11.2033. Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit, i themeluar sipas Vendimit të datës 28.04.2025 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, me rastin e publikimit të Njoftimit të datës 08.05.2025 të renditjes përfundimtare të kandidatëve, ka vepruar në pajtim Nenin 12 paragrafin 4 të Rregullores (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, ku përcaktohet se: *4. Kandidati që merr më së shumti pikë por jo më pak se pragu prej shtatëdhjetë (70) pikëve, konsiderohet kandidat fitues.*

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 08.05.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës *Asistent Administrativ*, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar.

Theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi i datës 08.05.2025, për shpalljen e kandidati fitues për pozitën e punës *Asistent Administrativ* pranë Komunës së Obiliqit, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.876/2025.

Atdhe Gashi

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.H
- Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në Obiliq
- Arkivit të KPMSHCK-së.